

**STUDIO SERVICES "D&S" SHPK**

Durrës, më 18.09.2023

**KONTRATE SHITJE KUOTASH**

Sot, më datën 18.09.2023, në zyrën e shoqërisë, **STUDIO SERVICES D&S shpk**, u paraqiten personalisht palët si më poshtë me cilësinë e shitësit dhe të bleresit, të cilët në bazë të nenit 705 e vijues të Kodit Civil si dhe të Ligjit 9901, "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, redaktuan këtë kontratë shitje – blerje kuotash si vijon:

**SHITESI:** Znj. Diana Dedja e bija e Surja-it e datëlindjes 09.08.1982, lindur në Durrës dhe banuese në lagjen 17, Rr,"Neki Libohova, Durrës, madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i Kartës së Identitetit Nr. I25809077K.

**BLERESI:** **Z. Kamerion SALILLARI**, i biri i Bashkimit dhe i Tatjanës i lindur në Durrës dhe banues në, lagjen 3, Rr," Egnatia," Pll.1039, K.3. Durrës, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i Kartës së Identitetit Nr. I40923014J.

**OBJEKTI:** Transferimin e 1 (një) kuote në vlerën 50% të kuotës së shoqërisë, **STUDIO SERVICES D&S shpk**, me NIPT: **L71305518R**, me adresë, lagja 3, Rr," Egnatia", dhe Rr," Ramazan Jella", Pll. 1125, K.1, Durrës, me administrator **Kamerion SALILLARIN**. Nga ortakut znj. **Diana Surja Dedja (shitësi)**, në dobi të z. Kamerion Bashkim Salillari (blersi) me vlere 500 (pesqind) lekë.

**BAZA LIGJORE** Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar dhe të Statutit të Shoqërisë.

Sipas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur deri në ditën e sotme të shoqërisë **STUDIO SERVICES D&S shpk**, rezulton se kjo shoqëri është regjistruar si person juridik me nr. NIPT: **L71305518R**.

Aktualisht ortakut i kësaj shoqërie z. Kamerion Bashkim SALILLARI posedon 50% të kuotave të kapitalit dhe znj. Diana Dedja posedon 50% të kuotave të kapitalit, pra në rastin konkret kuorumi i ortakeve është i plotë


Znj. Diana Dedja, bie dakord dhe jep pëlqimin e saj të transferimit të kuotave prej 50% që zotërohen tek ortakut Kamerion Bashkim Salillari

Objekti i shoqërisë është: sipas QKB-së datës së nënshkrimit të kësaj kontrate bashkangjitur kësaj kontrate.

Referuar ligjit 129/2014 "Per disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar" dhe konkretisht nenit 10 ku thuhet se "Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata", palët janë dakord që:

Adresa: Lagja, 3, Rr," Egnatia" dhe "Ramazan Jella", Pll. 1125, K.1, Durrës. CEL: 0696858514, NIPT: L71305518R e- mail: [ssds.shpk@hotmail.com](mailto:ssds.shpk@hotmail.com) FAQJA 1

  
  
**S.S.D & S. Sh.p.k NIPT: L71305518R**



## STUDIO SERVICES "D&S" SHPK

Pronesia mbi 1 (një) kuotë me vlerë 50% të kuotës, kalon nga *znj. Diana Dedja* (shitësi) do të kalojë në dobi të **z. Kamerion Salillari** (bleresi), menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate.

Pagesa në vlerën 500 (pesqind) lekë është likuiduar nga blerësi tek shitësi KESH, me marrveshje mes palëve.

Me depozotimin e akteve pranë QKB-së palët kanë detyrimin të paraqesin ekstratin e shoqërisë me ndryshimet përkatëse në të gjithë insitucionet dhe organet administrative ku kjo shoqëri ka ushtruar aktivitetin e saj dhe mbart të drejta dhe detyrime.

Kontrata pasi u lexua dhe u gjet sipas vullnetit të palëve nënshkruhet vullnetarisht në prani të shitesit dhe bleresit

Kontrates i bashkelidhen dokumentet përbërës të saj.

Kontrata u redaktua në katër kopje me fuqi të barabartë secila, ku njëra prej tyre arkivohet në këtë zyrë.

SHITËSI  
*Znj. Diana DEDJA*

BLERSI  
**z. Kamerion SALILLARI**

**S.S.D & S. Sh.p.k NIPT: L71305518R**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE DURRËS  
NOTER JULED A. BEQIRAJ



DATE 18/09/2023  
NR REP 5724

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 18.09.2023, para meje Noter JULED A. BEQIRAJ, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Durres, NR.4, EGNATIA, u paraqit personalisht:

**DEKLARUESIT:1-Diana Dedja**, atësia Surja, amësia Hatixhe, shtetase Shqiptare, lindur në Durrës dhe banues në Durrës, me adresë Raj 5 Rr. Neki Libohova; Nd. -; Durrës; Durrës; 2006; Durrës, lindur më 09/08/1982, gjendja civile “e martuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 034138640 dhe nr. personal I25809077K

**2-Kamerion Salillari**, atësia Bashkim, amësia Tatjana, shtetas Shqiptar, lindur në Durrës dhe banues në DURRËS, me adresë Shoqeria Bashkimi 00690756; Nd. 10; H. 15; Ap. 37; Durrës; Durrës; 2004; Durrës, lindur më 23/09/1984, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033784628 dhe nr. personal I40923014J .

**Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noterit, "Kontrate Shitje Kuotash" date 18/09/2023, bashkëlidhur.**

Unë Noteri, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma “ë”, si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

Juled  
Beqiraj

Firmosur elektronikisht nga  
NISA me certifikaten :Juled  
Beqiraj  
Data: 2023.09.18  
17:25:15+02.00

NOTER

JULED A. BEQIRAJ

